

NISMA PËR MBËSHTETJEN E GRURIT NË VEND

Më 1 shtator nisën aplikimet për mbështetjen e prodhuesve të grurit në vend. Brenda një viti buxhetor kryhen dy thirrje për aplikime nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Deri tani janë mbështetur më shumë se 35.000 fermerë dhe deri në fund të vitit llogariten rreth 50.000 fermerë që përmes naftës, grurit, apo masave të tjera të drejtpërdrejta do të mbështeten nga skema.

**VIZITË ME KRYEMINISTRIN NË GODINËN E RE TË
INSTITUTIT TË SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARE
(ISUV), RIKONSTRUKTUAR PAS TËRMETIT**

Bashkë me Kryeministrin Rama, u vizitua godina e re e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare e rikonstruktuar pas tërmetit me një investim të qeverisë shqiptare. Me vënien në punë të laboratorëve të rinj dhe metodave të reja të akredituara ISUV kontrollon nivelin e mbetjeve për 430 lloje pesticide në fruta dhe perime duke ofruar garanci për produktet që konsumohen në Shqipëri ashtu dhe për ato që i drejtohen tregjeve të huaja duke ndihmuar arritjen e objektivit tonë ambicioz për rritjen e eksporteve bujqësore.



**VIZITË ME KRYEMINISTRIN NË INVESTIMIN MË TË RI TË
PËRPUNIMIT TË BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE
NË FARKË**

Me Kryeministrin vizituam investimin më të ri të përpunimit të bimëve aromatike dhe mjekësore ngritur në Farkë falë mbështetjes nga AZHBR.

Me investimin e ri të përfutur nga programi IPARD, kompania ka rritur numrin e punonjësve si dhe kapacitetet për magazinim, tharje, përpunim, ambalazhim dhe tregtim.



Panairi i parë i verës Wine Vision u mbajt në Beograd, duke pasur në fokus promovimin e verërave vendase që morën pjesë. Gjatë 4 ditëve të Panairit të Verës Wine Vision by Open Balkan, u realizua edhe një konkurs i organizuar nga Shoqata e Verëtarëve dhe Vreshtarëve të Serbisë. Verërat shqiptare u vlerësuan me plot 12 medalje. Kantina Faba, Nurellari, Belba, Medaur, Duka u vlerësuan me Medalje të Artë, me Medalje Argjendi dhe Medalje Bronzi për Verën e Bardhë të Thatë si dhe për Verën e Kuqe të Thatë.

Në kuadër të iniciativës së Ballkanit të Hapur, është nënshkruar marrëveshja që garanton ngritjen e Mekanizmit të Sigurimit Ushqimor. Me ministrit e bujqësisë së Republikës së Serbisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut u dakordësua për heqjen e çdo bllokimi, ndalese apo kufizimi në sasi mbi eksportet e produkteve thelbësore bujqësore, përfshirë grurë, misër dhe produkte të tjera bazë mes tre vendeve tona.

**RITEN EKSPORTET BUJQËSORE
TË 8 MUJORIT 2022**



Vazhdon rritja e konsoliduar e eksporteve bujqësore në 8-mujorin e vitit 2022. Krahasimi me të njëjtën periudhë të një viti më parë, është regjistruar një rritje prej 55 milionë euro më shumë ose 22.4%. Nga 240 milionë euro në 8 mujorin 2021 në 295 milionë euro këtë vit. Gjithashtu rritja është regjistruar dhe në sasi, nga 244 tonë në 291 tonë, duke e rritur sasinë e eksportuar me 47 mijë tonë më shumë ose 19.6%.

**MIRATOHET NË PARLAMENT
FONDI I PROGRAMIT IPA III**

Është miratuar në parlament fondi i rëndësishëm për mbështetjen në bujqësi nëpërmjet programit IPA III. Pas suksesit të padiskutueshëm të disbursimit të fondeve të programit të kaluar që na ngjiti në krye të rajonit, me programin e ri Bujqësia do të përfitojë nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria shqiptare 146 milion Euro në kuadër të fondeve IPARD.



MINISTRIA KRIFCA, E PRANISHME NË SLOW FOOD EVENTS, SALONE DEL GUSTO, NË TORINO



Këtë vit, il Salone del Gusto, i është dedikuar RIGJENERIMIT dhe komuniteti i Slow Food Albania. I mbështetur për herë të parë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka konceptuar një zinxhir ushqimor të dedikuar grurit, kësaj kulture bujqësore kaq bazike por kaq të rëndësishme për jetët tonë. I gjithë ky zinxhir i cili promovon kulturën buknore shqiptare, shijet origjinale të territoreve tona biodiversive, ka një qëllim: RIGJENERAKSION, të rigjenerojmë tokat tona duke ruajtur historinë, traditën dhe identitetin.

**ZHVILLOHET PANAIRI I PARË I VERËS "WINE
VISION BY OPEN BALKAN", 12 MEDALJE PËR
VERËRAT SHQIPTARE**